



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-8**  
**22.01.2025**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastuar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.08-331 datë 26.12.2024 për heqje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-245/2 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur me datë 21.01.2025, miratoi

**Aktvendim**  
**për fshirje nga regjistri i transmetuesve**

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.
2. Ky Aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio pushon së vlefshmi me ligji, me heqjen e lejes nga Agjencia. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni në fjalë i Ligjit, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka pushuar së vlefshmi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 46-të mbajtur me datë 25.12.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-5193/2 datë 25.12.2024, miratoi Vendim PA1 nr.08-331 datë 26.12.202, me të cilën i hiqet leja për transmetim televiziv Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për të kryer veprimtarinë, respektivisht për shkak se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënie e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastuar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, respektivisht redaktori përgjegjës nuk është në marrëdhënie të rregullt pune dhe me orar të plotë të transmetuesit.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të

LSHMAAV, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.08-331 datë 26.12.2024, për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Riodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr. nr.02-245/2 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë në seancën e 2-të mbajtur më 21.01.2025, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi, riodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.